

**Vendim nr. 209 datë 13.10.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 13.10.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** SHYQIRI BALLA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 1257, datë 07.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.11115-01761-00-2014, datë 09.06.2022; nr. 00-2022-2081, datë 26.09.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënia në fuqi e vendimit nr. 625, datë 03.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër apo dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 7, 17, 42, 116, 131, pika 1 shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 28, 49, 50, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Shyqyri Balla ka në pronësi një ish-depo shtetërore, njëkatëshe, me sipërfaqe totale 86 m<sup>2</sup>, e cila është blerë nga ai përmes kontratës së shitjes së datës 23.02.1997 me degën e AKP-së, Bulqizë (ish-Ndërmarrja Shtetërore e Drithit, Shupenzë). Kjo pronë është e regjistruar me numër pasurie 184/2, në zonën kadastrale nr. 3444 në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Bulqizë. Kërkuesi është pajisur me vërtetimin përkatës nga dokumenti hipotekor i ZVRPP-së, Bulqizë, ku është shënuar se prona ndodhet në katin e parë të ndërtesës, të regjistruar sipas vendimit të AKP-së. Ai ka regjistruar, gjithashtu, sipas vendimit të AKP-së, edhe pasurinë me numër 184/4, të ndodhur, gjithashtu, në zonën kadastrale nr.3444 dhe me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, që është respektivisht kati i dytë i ndërtesës.

2. Në vijim, në datën 01.11.2011, kërkuesi ka lidhur një kontratë shitjeje me Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për truallin me sipërfaqe 116 m<sup>2</sup>, me objekt “Depo grumbullimi, kati i parë dhe kati i dytë”, në Shupenzë, ish-pronë e NGB Drithi, me numra pasurie 184/2 dhe 184/4. Kërkuesi ka bërë pagesën e vlerës së truallit të objektit në shumën 110.890 lekë. Në kushtet kur zona kadastrale nr.3444 Shupenzë nuk kishte hyrë ende në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i kësaj pasurie nuk është bërë në ZVRPP-në, Bulqizë.

3. Prona e kërkuesit kufizohet me pjesën jugore të pronës së shtetasit P. K., me sipërfaqe 2078,6 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 184/1 dhe e regjistruar në zonën kadastrale nr.3444, Shupenzë.

4.Shtetasi P.K. ka depozituar kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, me pretendimin se kërkuesi mban pa asnjë titull pronësie një sipërfaqe toke prej 308,4 m<sup>2</sup> nga pasuria e tij, duke kërkuar lirimimin e dorëzimit të saj, si dhe dëmshpërblimin në shumën 30.000 lekë në muaj për përdorimin e tokës.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.236, datë 15.04.2009, ka vendosur kthimin e padisë së bashku me aktet bashkëlidhur saj paditësit P. K. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësi.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.380, datë 12.11.2009, ka vendosur prishjen e vendimit civil nr. 236, datë 15.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe kthimin e

çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Kundër këtij vendimi, ka ushtruar rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2012-843, datë 12.04.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit nr. 380, datë 12.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8.Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.625, datë 03.12.2012, ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit P. K. si të pabazuar në prova dhe në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkimi i tij gjyqësor për kthimin e sipërfaqes prej 304.8 m<sup>2</sup> nuk gjente mbështetje në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhej rrëzuar. Për rrjedhojë, edhe kërkimet dytësore për pagimin e të ardhurave të realizuara nga posedimi me keqbesim i sendit sipas nenit 298 të Kodit Civil ishin të pabazuara në ligj dhe si të tilla duhen rrëzuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi P. K.

9. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1257, datë 07.04.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.625, datë 03.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke përcaktuar detyrimin e kërkuesit t'i lirojë dhe dorëzojë paditësit P. K. sipërfaqen prej 48,7 m<sup>2</sup>, të përcaktuar në planvendosjen nr.3 të aktit të ekspertimit. Po kështu, kjo gjykatë ka vendosur që akti i ekspertimit të jetë pjesë e këtij vendimi, si dhe ka rrëzuar pjesën tjetër të padisë. Gjykata ka arsyetuar se në aktin e ekspertimit të paraqitur me shkrim dhe të relatuar përpara saj, ekspertët kanë dalë në përfundimin kategorik se kërkuesi mban pa titull pronësie një sipërfaqe prej 48.7 m<sup>2</sup> nga trualli në pronësi të paditësit P. K. Kundër këtij vendimi, në datën 28.04.2014, kërkuesi ka ushtruar rekurs. Në datën 02.05.2014, edhe paditësi P. K. ka ushtruar, gjithashtu, rekurs.

10. Fillimisht, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. -00-2016, datë 23.09.2016, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm, datë 09.06.2022, ka vendosur revokimin e vendimit të datës 23.09.2016 të gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve. Ky kolegji ka arsyetuar se duke pasur në konsideratë natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe mbështetur në nenin 171/b, paragrafi i dytë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), nuk ka pengesë ligjore për revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve.

11. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2081, datë 26.09.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura kërkuesi dhe shtetasi P. K., pasi ishin bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së.

12. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 31.07.2023 me ankim kushtetues individual, sipas objektit, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimit të revokimit dhe atij përfundimtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

13.1. *Së drejtës për gjykim të drejtë publik*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin për ta gjykuar çështjen në themel në seancë gjyqësore në prani të palëve, pasi vendimi i ankimuar bie ndesh me praktikën gjyqësore të saj.

13.2. *Së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe pse e ka njoftuar palën rekursuese për gjykim në dhomën e këshillimit dhe për të paraqitur parashtrime, nuk ka njoftuar për gjykimin ose jo në themel të çështjes. Po kështu, parashtrimet e kërkuesit nuk janë vlerësuar, nuk janë referuar në proces, nuk janë pjesë e sekretimit të fashikullit gjyqësor, si dhe nuk janë reflektuar në vendim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Gjykata ka kërkuar parashtrime me shkrim, për formimin e provës gjatë gjykimit në themel, ndërkohë që ato nuk janë vlerësuar as *prima facie*. Gjykata e Lartë, në vendim, i ka bërë referencë në mënyrë selektive rekursit shtesë të palës tjetër, ndërkohë që në të nuk gjejmë referim parashtrimet e mbrojtjes.

13.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është në thelb kontradiktor, pasi, nga njëra anë, kjo gjykatë ka pranuar pjesërisht padinë e paditësit P. K., duke e detyruar kërkuesin t'i lirojë dhe dorëzojë atij sipërfaqen e tokës 48,7 m<sup>2</sup> dhe, nga ana tjetër, ka rrëzuar pjesën tjetër të padisë për shpërblimin e dëmit ndaj paditësit, duke vënë në dyshim të drejtën e pronësisë së tij. Vendimi i datës

23.09.2016 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e ka pranuar rekursin e kërkuarit, që në thelb ka mbetur i pacenuar nga vendimi i revokimit i datës 09.06.2022 të Kolegjit Civil të kësaj gjykate. Ky rekurs është i pranuar po nga ky kolegji në rrethanat e referuara në vendimin përfundimtar, por i pavlerësuar me ligj prej tij. Vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore është i formës së prerë dhe i paankimueshëm *ex-lege* dhe, si rrjedhim, Gjykata e Lartë nuk mund ta revokonte atë. Po kështu, kjo gjykatë nuk ka arsyetuar lidhur me parashtrimet e kërkuarit, të cilat nuk janë reflektuar në vendim.

13.4. *Parimit të kontradiktoritetit në lidhje me provat*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë ka pasur një reagim joligjor, duke mos i marrë në shqyrtim dhe duke mos dhënë arsye ligjore për mospranimin e kundërshtimeve me shkrim dhe atyre verbale të kërkuarit në seancë. Ekspertimi i kryer bazohet në akte që nuk janë pjesë e procesit. Gjykata nuk e ka pranuar kërkesën e kërkuarit për ballafaqimin e aktit të ekspertimit me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Bulqizë. Nëse faktet nuk përballen me pretendimet dhe prapësimet e palëve do të thotë se ato nuk vlerësohen me ligj. Çështja e vlerësimit të provave nuk përbën juridiksion ekskluziv të Gjykatës së Lartë, por mënyra e të vlerësuarit të tyre në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, në aspekt të një hetimi të plotë e të gjithanshëm për të arritur në vlerën reale të provës, si dhe në kuadrin e një cilësimi të saktë të fakteve dhe rrethanave, dhënies përgjigje dhe arsyetimit ligjor ndaj pretendimeve e prapësimeve të palëve, përbën tagër gjyqësor edhe për këtë gjykatë. Ndonëse Gjykata e Lartë ka pranuar rekursin *prima facie* dhe pranon pavlefshmëritë dhe mungesën e tagrit të pronës, vlerësimi ndaj tyre është bërë në mënyrë të paligjshme.

13.5. *Parimit të sigurisë juridike*, të lidhur me parimet *res judicata* dhe *ne bis in idem*, pasi vendimi i revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i paligjshëm, pasi, në dukje, revokon kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa në thelb cenon në mënyrë të paligjshme vendimin për pranimin e rekurseve. Duke marrë në konsideratë vendimin përfundimtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky i fundit ka gjykuar për të njëjtën gjë, pra për pranimin ose mospranimin e rekurseve që, në thelb, përbën gjë të gjykuar. Gjykata e Lartë ishte e detyruar ta gjykonte çështjen në themel, në seancë gjyqësore ose në dhomën e këshillimit, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve dhe prapësimeve në rekurset e pranuar për gjykim.

13.6. *Së drejtës për një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe të caktuar me ligj*, pasi në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka qenë anëtar gjyqtari A. K., i cili ka qenë, gjithashtu, edhe gjyqtari relator gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit. Në datën 30.06.2022, ky gjyqtar ka bërë kërkesë për përjashtim nga trupi gjykues për të mos gjykuar çështjen në themel, kërkesë e cila i është miratuar në datën 06.07.2022. Gjykimi në Gjykatën e Lartë, për çdo kërkesë procedurale të palëve zhvillohet nga i njëjti trup gjykues dhe në rastin konkret ky gjykim është zhvilluar *de plano* në bazë dokumenteve. Në këto kushte, nuk kishte se përse të ndryshohej përbërja e trupit gjykues, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vlerësuar se tej gjykimit në themel trupi gjykues ka qenë i ligjshëm. Ndryshimi i trupit gjykues është bërë pikërisht se çështja duhej dhe do të gjykohej në themel. Papajtueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes, ligjvënësi e ka lidhur me shkallën e gjykimit dhe jo me fazën procedurale brenda shkallës së gjykimit në themel ose jo.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. *Për legjitimimin e kërkuarit*

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit, vendimin e revokimit dhe atë përfundimtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku ky i fundit ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të nisur prej tij. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

19. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 26.09.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur është paraqitur fillimisht në datën 17.07.2023 dhe pas plotësimit është regjistruar në Gjykatë në datën 31.07.2023, pra në dukje jashtë afatit ligjor të lartpërmendur. Kërkuesi ka pretenduar se është në afat, pasi ka marrë dijëni për këtë vendim në datën 02.06.2023, datë në të cilën ka tërhequr vendimin gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Këtë pretendim kërkuesi e ka mbështetur në qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. kundër Shqipërisë”, datë 09.05.2023.

20. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon të ecë afati i paraqitjes së ankimit kushtetues individual, konsiderohet data në të cilën kërkuesi merr dijëni efektivisht për vendimet gjyqësore dhe në këtë drejtim vënia në dispozicion të palëve e

vendimeve të gjykatës ua bën të ditura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen, pasi janë njohur me vendimin e arsyetuar (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nisur nga sa më lart, duke mbajtur në konsideratë se vetëm njohja me vendimin e arsyetuar u mundëson palëve ta ankimojnë atë nëse e shohin të arsyeshme, Kolegji vëren se si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, në rastin e procesit gjyqësor, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim i Gjykatës së Lartë, si datë e marrjes dijeni për vendimin gjyqësor është ajo kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare të saj ose me njoftimin elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit.

22. Në rastin konkret, Kolegji vëren se sipas informacionit të marrë përmes shkresës nr. 4565/1 prot., datë 25.09.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt i ankimit kushtetues individual është publikuar në faqen zyrtare të internetit të kësaj gjykate në datën 05.12.2022, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim. Po kështu, nga materialet e depozituara bashkëlidhur kërkesës, rezulton se rekursi i kërkuarit nuk përmban të dhënat e adresës së tij elektronike, duke e pamundësuar këtë formë komunikimi për vendimin nga Gjykata e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 482, pika 3, të KPC-së.

23. Kolegji konstaton, gjithashtu, se sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se përmes shpalljes së datës 27.07.2022 kjo gjykatë ka njoftuar shqyrtimin e çështjes së kërkuarit në dhomën e këshillimit në datën 26.09.2022, si dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Civil të saj që do të shqyrtonte çështjen.

24. Në këto kushte, në kontekstin e fakteve dhe rrethanave të çështjes konkrete, duke qenë se kërkuari nuk ka parashtruar asnjë argument ose provë se përse nuk ka mundur të marrë dijeni efektive për vendimin e arsyetuar kur ai është bërë i disponueshëm, Kolegji çmon se si moment i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese nga kërkuari do të konsiderohet data 05.12.2022, kur vendimi i kundërshtuar është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Ndaj, edhe në këtë aspekt pretendimi i tij se ka marrë dijeni për këtë vendim në datën 02.06.2023, datë në të cilën ai është paraqitur për ta tërhequr atë, nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese.



25. Në përmbledhje të analizës si më lart, në kushtet kur që prej datës 05.12.2022 kërkuesi konsiderohet se ka pasur mundësi të njihet me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i datës 17.07.2023 është paraqitur tej afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione temporis* për të paraqitur kërkesën drejtuar Gjykatës, sipas objektit.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.